
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Tiranë, më 28.05.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Konceptim, ndërtim dhe zhvillim të platformës digjitale të edukimit “Mësojmë nga e kaluara- Burime Arsimore të Hapura 1944-1991”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP): 483000000-1, 48190000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,193,333.33 (tetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të

lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cileneshte e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 10 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 1/b dhe pika 3, e LPP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të vendosi kërkesa të cilat garantojnë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën si dhe në nenin 43 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon një kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”* Gjithashtu në përputhje me nenin 55, pika 4, paragrafi 1 dhe 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 39% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”*

Në vendosjen e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni nr. 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si edhe rekomandimi APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të

vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë;
- ISO 27001 për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit;

Shënim: Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 1, të nenit 79, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “*Autoriteti ose enti*

kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe referuar nenit 44 pika 1., të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca/ profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron, garantimi i një procesi cilësor të furnizimit e shërbimit sigurimi i konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Përmbushja e standardeve ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

- ISO 27001 për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ky standard specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë së informacionit dhe veprimi ndaj këtyre rreziqeve (i ashtuquajtur “trajtimi i rreziqeve”) përmes kontrolleve të sigurisë së informacionit në pajtim me kërkesat e standardit përfaqësojnë një bazë të sigurt për të siguruar konfidencialitetin, disponueshmërinë dhe integritetin e informacionit përkatës dhe arritjen e objektivave të dëshiruara të sigurisë. Siguron një kornizë për zbatimin e politikave, procedurave dhe masave në proceset e menaxhimit të rrezikut të informacionit të organizatës. Nisur nga rëndësia e kontratës, rëndësia e AK të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike sipas kërkesave të parashikuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 5 (pesë) punonjës të siguruar, ku të përfshihen jo më pak se 4 (katër) Inxhinierë/ Specialistë të siguruar, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informatike/ Informatikë / Informatikë Matematikë/ Inxhinieri Matematike dhe Informatikë/Informatikë Ekonomike/ Inxhinieri Telekomunikacioni që do të angazhohen në implementimin e projektit. Për keta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e projekteve (PMP ose ekuivalente).
- b) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software.
- ç) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për server administration.

*Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

*Shënim: Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtetohen me Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.” Numri minimal prej 5 punonjësish të siguruar, ku të paktën 4 prej tyre duhet të jenë inxhinierë/specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit përbën një kërkesë minimale të domosdoshme për të garantuar konceptimin, implementimin, mirëfunksionimin dhe vijueshmërinë e shërbimit objekt kontrate. Duke marrë në konsideratë natyrën teknike të projektit, secili prej specialistëve të kërkuar mbart një rol të rëndësishëm në realizimin e fazave të ndryshme të shërbimit, si analiza dhe projektimi i sistemit, konfigurimi dhe implementimi teknik, administrimi i infrastrukturës, integrimi i komponentëve teknologjikë, testimi, siguria e të dhënave, si dhe mbështetja teknike dhe mirëmbajtja gjatë zbatimit të kontratës. Për më tepër, disponimi i një stafi minimal të specializuar garanton që operatori ekonomik të ketë kapacitete reale njerëzore për përballimin e situatave të paparashikuara, si mungesat për arsye objektive, pa cenuar cilësinë dhe

vazhdimësinë e shërbimit. Kërkesa për të provuar marrëdhënien e punës nëpërmjet formularëve E-SIG për 3 muajt e fundit synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon efektivisht personelin e nevojshëm dhe nuk mbështetet në kapacitete të deklaruara formalisht vetëm për qëllime kualifikimi. Në këtë kuptim, kriteri rezulton i arsyeshëm, funksional dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke mos krijuar barriera të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Ky kriter është plotësisht i lidhur me natyrën dhe kompleksitetin e procedurës së prokurimit me objekt pasi realizimi i një platforme të tillë kërkon jo vetëm zhvillim teknik, por edhe koordinim profesional, garantim të cilësisë së sistemit, siguri infrastrukturore dhe menaxhim efikas të proceseve të implementimit.

Konkretisht, prania e një specialisti të certifikuar në menaxhimin e projekteve (PMP ose ekuivalente) është thelbësore për organizimin dhe koordinimin e të gjitha fazave të realizimit të platformës, duke garantuar planifikimin e detyrave, respektimin e afateve, administrimin e burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe komunikimin e vazhdueshëm me autoritetin kontraktor. Duke qenë se projekti përfshin konceptimin dhe ndërtimin e një platforme digjitale edukative me rëndësi publike dhe historike, menaxhimi profesional i projektit është një element kyç për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për dy programues të certifikuar lidhet drejtpërdrejt me vetë natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në zhvillimin dhe implementimin e një platforme digjitale funksionale. Programuesit janë përgjegjës për arkitekturën teknike të sistemit, zhvillimin e moduleve funksionale, integrimin e databazave, ndërtimin e ndërfaqeve të përdoruesit, si dhe garantimin e performancës dhe aksesueshmërisë së platformës. Duke marrë në konsideratë se platforma do të shërbejë si një burim arsimor i hapur dhe do të administrojë përmbajtje historike dhe edukative, prania e më shumë se një programuesi është minimale dhe e nevojshme për të garantuar vazhdimësinë e punës dhe mbulimin e proceseve zhvilluese.

Po kështu, specialisti i certifikuar për testim software luan një rol thelbësor në garantimin e cilësisë së platformës përpara vënies në funksion. Testimi i sistemit siguron identifikimin e gabimeve teknike, verifikimin e funksionaliteteve, stabilitetin e platformës dhe përputhshmërinë e saj me kërkesat funksionale të autoritetit kontraktor. Në mungesë të këtij roli, ekziston rreziku që sistemi të paraqesë problematika funksionale apo cenueshmëri teknike që do të ndikonin drejtpërdrejt në përdorimin e platformës nga publiku dhe institucionet arsimore.

Ndërsa kërkesa për një specialist të certifikuar në administrimin e serverave është e lidhur ngushtë me nevojën për garantimin e infrastrukturës teknologjike mbi të cilën do të funksionojë platforma. Ky rol është i domosdoshëm për konfigurimin, mirëmbajtjen, sigurinë, backup-et, performancën dhe stabilitetin e serverave dhe databazave ku do të hostohet platforma digjitale. Duke qenë se platforma do të përmbajë materiale edukative dhe historike me akses të vazhdueshëm për përdoruesit, siguria dhe disponueshmëria e sistemit përbëjnë elementë thelbësorë të kontratës.

Gjithashtu, fakti që autoriteti kontraktor ka parashikuar shprehimisht se një punonjës mund të disponojë më shumë se një certifikim tregon se kriteri është hartuar në mënyrë proporcionale dhe jo diskriminuese, duke synuar sigurimin e kompetencave minimale profesionale dhe jo rritjen artificiale të numrit të stafit. Për rrjedhojë, kriteri rezulton i arsyeshëm, proporcional dhe i domosdoshëm për garantimin e realizimit me cilësi dhe siguri të platformës digjitale objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër të kryejë shërbimin sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në

varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës/ave, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit në përputhje me rekomandimet e Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit dhënë për këtë procedurë. Përlllogaritja e fondit limit është përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.